



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:287469
Datë: 14.03.2024
Numri i dokumentit: 05452385

Në ankesën e

AC-I-24-0134-A0001

Paditësi/Ankuesi

II Prishtinë – i përfaqësuar nga Avokatia, "I L", Prishtinë, me avokat R F,
Prishtinë.

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakrishtë, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, Shkelzen Sylaj, Diellza Hoxha, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktvendimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-I-23-0048 të datës 23 janar 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 14 mars 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktvendimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-I-23-0048 të datës 23 nëntor 2024.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me 19 dhjetor 2023, paditësi (tutje ankuesi) dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një padi kundër të paditurës për shkak të anulimit të Vendimit të bordit të Drejtorëve të AKP-së, Nr.ref.BD-189/29 të datës 30 tetor 2023 me të cilin është aprovuar Raporti Shqyrtues i Komisionit për Shqyrtimin e KPS-së i datës 15 shtator 2023 lidhur me statusin juridik të aseteve, PS/SDR/-153U/PRN193, Ndërmarrjes Organizatë e Punës, "Nacional" Beograd, asetet në Prishtinë, Kosovë, e më të cilën padi ka kërkuar nga gjykata që ta aprovojë në tersi kërkesëpadinë, dhe ta anulojë Vendimin, NR.REF.BD-189/29 të datës 30 tetor 2023 të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe të obligohet e paditura që ti paguajë shpenzimet gjyqësore lidhur me këtë çështjen gjyqësore, po ashtu ka propozuar që të caktohet Masa e Sigurimit të i ndalohet të paditurës që të ndërmarre veprime në drejtim të shitjes, tjetërsimit, fshehjes, ngarkimit apo disponimit/administrimit me lokalit afarist., me sipërfaqe prej 63.03 m², me adresë në Prishtinë, lagja D kati i ndërmjetëm, i cili është në posedim të paditësit, si dhe të obligohet e paditura që ta pezullojë zbatimin e vendimit nr.Ref.BD-189/29 të datës 30 dhjetor 2023 deri në zgjedhjen meritorë të kësaj çështjes.

Paditësi në padi ka theksuar se objekt i padisë është lokali afarist me adresë në Prishtinë, rr."D",SU-1/1/3A,L2, me sipërfaqe të përgjithshme prej 63.03 m², lidhur me të cilin e paditura pretendon se është në administrimin e saj, pasi që me 30 tetor 2023, e paditura kishte nxjerrë Vendimin me Nr.Ref.BD 189/29 të datës 30 tetor 2023, me të cilin e ka aprovuar Raportin shqyrtues të Komisionit për shqyrtimin e KPS-së të datës 15 shtator 2023 lidhur me statusin e juridik të aseteve, PS/SDR/-1537U/PRN193, Ndërmarrjes Organizatë e Punës," Nacional", në Prishtinë, pjesë e së cilave, është edhe lokali i lartcekur. Paditësi ka theksuar se organizata punuese me emërtimin "Nacional" , në bazë të regjistrimit gjyqësor, Nr.1-1951-00 të datës 22 tetor 2003 të Gjykatës Tregtare në Beograd, është regjistruara si Shoqëri Aksionare me emërtimin "N" AD dhe me nr. zyrtar XVI-Fi-8322/03. Tutje thekson se Shoqëria aksionare "N" D.A, me seli në Beogard nuk ka qenë asnjëherë e regjistruar në republikën e Kosovës si NSH, apo si subjekt i regjistruara në

Gjykatën ekonomike të Kosovës, madje as nuk ka pasur ndonjë njësi punuese të saj të regjistruara. Me .. nëntor .. SH.A "N" A.D, kishte kontratë me sekretariatën Krahinore për punët e brendshme në Prishtinë , për bashkimin e fondeve për ndërtimin e hapësirave afariste L1 dhe L2(në tekstin vijues "kontratë për bashkimin e fondeve), në Prishtinë, ku në bazë të kësaj kontrate Shoqria Aksionare N A.D do të behej pronare e dy lokaleve L1 me sipërfaqe prej 69.11 m2, në katin përdhes dhe L2 me sipërfaqe prej 63.03 m2 në katin e ndërmjet, ku ky i fundit objekt i këtij kontesti. Ka shtuar se SH.A "N" A.D me 04 qershor 2002, në gazetën zyrtare të quajtur "privredni pregled" ka shpallur në shitje disa asete ndër to edhe sipërfaqen e hapësirës afariste kontestuese me çmim fillestar 1,650.000 dinar.(njëmilion e gjashtëqind e pesëdhjetë dinar). Me 18 qershor SH.A "N" A.D kishte nxjerr vendim, dhe kishte miratuar shitjen e objekti kontestues ish punëtorit-paditësit I I në shume prej 27,000 euro, ku paditësi me te njëjtën ditë kishte lidhur edhe kontratën e shitblerjes me nr. ..me SH.A "N" A.D, për blerjen e lokalit i cili është objekt i këtij kontesti dhe se me dt.19 qershor 2002, SH.A "N" A.D kishte lëshuar faturën Nr.01/02-OS, si vërtetim se paditësi kishte kryer pagesën 27,000 euro. Paditësi ka shtuar se ai kishte iniciuar padi në DHPGJS me nr,C-III.-18-0049, për vërtetimin e pronësisë për hapësirën afariste që është objekt i këtij kontesti. Paditësi padisë i ka bashkangjitur këto prova: kopje e Vendimit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, Nr.Ref.BD.-189/29 të datës 30 tetor 2023, kopja e kontratës për bashkimin e fondeve , kopja e shpalljes publike e datës e datës 04 qershor 2002, në gazetën Zyrtare "privredni pregled", kopjen e Vendimit nr.1301 të datës 18 qershor 2002, Beograd për shpalljen e blerësit të lokalit, L 2 me sipërfaqe 63.03 m2, kopja e autorizimit për F Bdhe kontrata e shitblerjes nr....e datës ..qershor .., koja e kontratës së shitblerjes, Nr....e datës ..qershor .., e lidhur në mes, shoqërisë Aksionare "N" me seli në Beograd dhe I I nga Prishtina për blerjen e lokalit, kopja e faturës, Nr.01/02-OS e datës 19 qershor 2002, për kryerjen e pagesës sipas kontratës së shitblerjes, nr....e datës ..qershor .., vërtetimin, nr... për ekzekutimin e pagesës nga paditësi dhe kopja e shkresës së AKP-së, nr.2647/2023, nr1 e datës 17 nëntor 2023 për shfrytëzuesit e pronës së Ndërmarrjes, "Organizatrat e Punës, "Nacional" të dërguar në adresë të paditësit.

Paditësi në kërkesën për caktimin e masës së sigurimit, në mes tjerash ka cekur nenin 61.12 të Ligjit, nr.06/L086 për DHPGJS, ku për caktimin e masës së sigurimit, kërkohet plotësimi i dy kriterëve ligjore për caktimin e masës së sigurimit: a) ekzistimi i kërkesës apo të drejtës subjektive, si dhe b) rreziku i shkaktimit të dëmit të menjëhershëm dhe të pa riparueshëm në rast se nuk ndërmerret.

Paditësi në propozimin për caktimin e Masës së Përkohshme ka theksuar se i njëjti, e ka blerë lokalin afarist., me sipërfaqe prej 63.03 m², me adresë në Prishtinë, Rr. D, përmes kontratës së shitblerjes sipas rregullave ligjore të asaj kohe dhe është posedues i të njëjtit edhe sot e kësaj dite, se në shkresat e lëndës, ka parashtruar dëshmi se ka paguar shumën prej 27,000 euro (njëzetë e shtatë mijë) në bazë të kontratës së shitblerjes, nr.1.. e lidhur me shoqërinë aksionare, "N" A.D, në cilësinë e shitëses, si dhe pagesën e ka vërtetuar në bazë të vërtetimit për ekzekutimin e pagesës dhe mbylljes së detyrimit e lëshuar nga kjo e fundit, se në rastin konkret është plotësuar kushti i parë ligjor nga 61 par 1.1 i Ligjit për DHPGJS, probabiliteti se ekziston e drejta e kërkuar, dhe se ekziston rreziku i shkaktimit të dëmit të menjëhershëm dhe të pa riparueshëm në rast se masa e sigurimit nuk ndërmerret, se e paditura në bazë të Vendimit nr.Ref.ND.189/29, ka konstatuar se paluajtshmëria, e cila është objekt kontesti midis palëve ndërgjyqëse, si aset i SH.A, "N" A.D, është e fituar me mjete shoqërore rrjedhimisht është në pronësi shoqërore dhe kësajsoj e njëjta bie në administrimin dhe juridiksionin e AKP-së, e në bazë të nenit 1 dhe 2 të Ligjit, Nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Pas nxjerrjes së Vendimit të Bordit të drejtorëve të AKP-së, Nr.ref.BD-189/29 të datës 30 tetor 2023, e paditura ia ka dërguar paditësit shkresën e saj, nr.2647/2023, nr.1 e datës 17 nëntor 2023, duke e informuar se ishte duke e shfrytëzuar asetin e ndërmarrjes në fjalë pa marrëveshje me AKP-në, e në mes tjerash me këtë shkresë, i kishte kërkuar që të ofrojë dokumente mbi bazën e të cilave është duke e shfrytëzuar pronën, detyrohej që të hynte në marrëdhënie kontraktuale, siç ishte pagesa e qirasë me AKP-në në mënyrë retroaktive për 3 vitet e fundit e nëse nuk do t'i realizonte këto kërkesa. Është njoftuar se është i detyruar të lirojë asetin në fjalë (lokalin afarist L2, objekt kontesti dhe se AKP-ja, do të ndërmarrë veprime ligjore para gjykatës me qëllim të kompensimit.

Paditësi ka theksuar se po i rrezikohet shkelja e të drejtës së pronësisë në mënyrë flagrante duke e larguar kundërligjshëm nga prona e tij dhe duke e detyruar që t'a paguajë qiranë në mënyrë retroaktive për 3 vitet e fundit në rast të mbajtjes në posedim të lokalit mbi bazën e kontratës së qirasë me AKP-në, se atij po i rrezikohet edhe shkaktimi i rrezikut të menjëhershëm dhe të pa riparueshëm, se ka cituar dispozitat e nenit 3 të Ligjit, nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Demi i menjëhershëm konsiston në atë se lokali afarist do të vendoset nën administrimin e AKP-së ndërsa ai do të detyrohet në pagimin e qirasë, se AKP-ja menjëherë në raundin e radhës do ta vendos asetin në shitje përmes tenderit publik, se shitja do të nënkuptonte dorëzimin në posedim dhe pronësi tek një person i tretë nëse ndodh shitja e asetit për të cilin paditësi, ka iniciuar këtë padi, kjo cenon të drejtën në gjykim të drejtë (neni 6 i KEDNJ-së) dhe të drejtën në mbrojtje të pronës (neni 1 i Protokollit 1 të KEDNJ-së), se dëm i riparueshëm, konsiston në atë se nuk ka një zhdëmtim të arsyeshëm financiar, sado që gjykata do të caktonte çmim për lokalin afarist kontestues, se ky dëm konsiston në mohimin e një të drejte themelore të njërit, se beson se me provat e parashtruara si dhe faktet dhe argumentet ligjore vërtetojnë dhe e bëjnë të besueshme pretendimin se aseti-lokali L 2 me sipërfaqe prej 63.03 m². Paditësi konsideron se ky aset nuk mund të tjetërsohet nga Agjencia pa poseduar as dhe të vetmin dokument, provë apo fakt juridik si dëshmi se ky aset bie nën juridiksionin e agjencisë, andaj i ka propozuar gjykatës që të merr aktvendim e me të cilin do të caktohet masa e sigurimit e ushtruar paditësi, dhe ti ndalohet të paditurës, që të ndërmarre veprime në drejtim dhe i cili është në posedim të paditësit, si dhe të obligohet e paditura, Agjencia Kosovare e Privatizimit që të pezullojë zbatimin e vendimit, Nr.ref.BD-189/29 të datës 30 tetor 2023 deri në zgjidhjen meritore të kësaj çështje.

Më 27 dhjetor 2023, AKP-ja ka paraqitur përgjigjen në padi e në të cilën ka theksuar se i konteston në tersi, padinë dhe pretendimet e paditësit si dhe provat e propozuar, se Bordi i Drejtorëve i AKP-së, ka vepruar drejtë në pajtim me ligjin për AKP-në me aprovimin e raportit Shqyrtues të Komisionit për Shqyrtimin e KPS-së të datës 15 shtator 2023 lidhur me statusin juridik të aseteve, SDR1537U/PRN193, ndërmarrjes Organizatë e Punës, "N", në Prishtinë. Ka shtuar se dokumentet e bashkangjitura në padi nuk paraqesin argument ligjore dhe nuk kanë fuqi juridike.

Lidhur me propozimin e paditësit për caktimin e masës së sigurimit ka theksuar se propozuesi në propozim duhet të tregojë edhe faktet mbi të cilat e mbështet propozimin si dhe të propozohen, mjetet provuese me të cilat mund të provohen pretendimet e parashtruara në propozim. Paditësi duhet ta bëj të besueshme pretendimin se masa e sigurisë është e bazuar, duke prezantuar urgjencën e çështjes e cila kërkohet lidhur me atë rast dhe se me veprimin ndryshe do të humbte qëllimi i sigurimit të kërkesë padisë, se e paditura sqaron se baza juridike për vendosje e masave nga DHPGJSK-ja, është neni 61 i Ligjit të DHPGJS-së, se parashtruesi duhet në kërkesën për masën e sigurisë, të paraqes një pasqyrë gjithëpërfshirëse dhe të hollësishme dhe rrethanave faktike prej të cilave mund të nxirret përfundimi se ekziston dëmi gjithëpërfshirës, i cili është i menjëhershëm dhe i pa riparueshëm. Se me dëm do të duhej kuptuar jo vetëm humbja financiare apo monetare por edhe çdo kuadër i rrethanave që ekziston apo dëmton të drejtën e pretenduar nga parashtruesi (*periculum in mora*). Me fjalën i menjëhershëm do të duhej nënkuptuar diçka që është duke ndodhur, por gjithashtu diçka që në pajtim me rrethanat, është e pa pashmangshme, me mundësi të mëdha për të ndodhur në një të ardhme të afërt, duke pasur parasysh kohëzgjatjen e procedurës së urdhrit paraprak gjyqësor. Me fjalën, i riparueshëm do të duhej nënkuptuar ajo çfarë nuk mund të zhdëmtohet në mënyre të arsyeshme, posaçërisht për nga natyra e vet apo nga çfarë nuk mund të zhdëmtohet në mënyre të arsyeshme, veçanërisht për nga natyra e vet apo e llogaritjes, me anë të një kompensimi monetar, se më prova të besueshme, do të duhej nënkuptuar se është veçmas e domosdoshme të krijohet të gjyqtarët në mënyre, "summario cognito", bindjen "Primaface", se parashtruesi ka të drejtë se më pretendimin se ekziston "fomua boni iuis". Agjencia i ka propozuar DHPGJS, që pas shqyrtimit të provave dhe thënieve nga e paditura, të nxjerrë aktvendim me të cilin, hedhet poshtë si e pa pranueshme kërkesa për lëshimin e masës së sigurisë e paditësit ose të merre aktgjykim me të cilin refuzohet si e pa bazuar padia e paditësit dhe se kësaj përgjigje ia ka bashkangjitur, provat: Kopjen e shkresës, Nr.2647/2023 të datës 17 nëntor 2023 të Zyrës Rajonale të AKP-së në Prishtinë për shfrytëzuesit e aseteve të pronës shoqërore e të dërguar në adresë të shfrytëzuesit të Ndërmarrjes, "Organizate e Punës, "Nacional", dhe Raportin përmbledhës të Komisionit nga

shqyrtimi i kërkesës për përcaktimin e statusit juridik të aseteve të Ndërmarrjes, P, " Nacional", Beograd, Njësia punuese në Prishtine Ref; KPS1537U PRN193.

Më 16 janar 2024, paditësi ka paraqitur përgjigje në përgjigjen e dhënë nga e paditura në padinë e paditësit por edhe ndaj përgjigjes së dhënë nga e paditura për caktimin e masës së sigurimit, e cila i ka dhënë arsyet e njëjta të thëna në propozimin e saj për caktimin e masës së sigurimit e veçmas duke kërkuar nga gjykata që ta anulojë, Vendimin nr.Ref.BD-189/29 të datës 30 tetor 2023, dhe që të caktohet masa e sigurimit, ti ndalohet të paditurës që ti ndërmarre veprimet në drejtim të shitjes, tjetërsimit, fshehjes, ngarkimit apo deponimit/administrimit me lokalit objekt i këtij kontesti.

Me 23 janar 2024, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së, ka marrë Aktvendimin C-I-23-0048, me të cilën e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesa e paditësit-Propozuesit të sigurimit. Në arsyetim të vendimit thuhet se Gjykata pasi ka bërë shqyrtimin e propozimit për caktimin e masës së sigurimit si dhe pretendimet e të paditurës të dhen anë përgjigjen e saj dhe në kundërpërgjigjen e saj ndaj përgjigjes së paditësit, ka ardhë në përfundim se propozimi i paditësit për lëshimin e masës së sigurimit, në këtë çështje juridike është i pa bazuar. Shkalla e I-rë duke u bazuar në nenin 61 par.1 të Ligjit nr.06/L086 të DHPGJS, i cili parasheh që : Dhoma e Posaçme mund të caktojë një masë të sigurimit me kushte që parashtruesi jep prova të besueshme për ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij, dhe se do të ketë dëme të menjëhershme dhe të pariparueshme për palën nëse nuk miratohet masa e sigurimit. Në rastin konkret paditësi, i ka propozuar gjykatës që të caktohet masa e sigurimit dhe ti ndalohet të paditurës të ndërmarre veprime në drejtim të shitjes, fshehjes, tjetërsimit , ngarkimit apo disponimit/administrimit me lokalit afarist, me sipërfaqe prej 63.03 m2, me adresë në Prishtinë, D, kati i ndërmjetëm, i cili është në posedim të paditësit, si dhe të obligohet e paditura që ta pezullojë zbatimin e vendimit Nr.ref.BD-189/29 të datës 30 tetor 2023 deri në zgjidhjen meritorë të kësaj çështje. Shkalla e i-rë kishte theksuar se për të përcaktuar kushtet paraprake rreth miratimit të masës së përkohshme të sigurimit, paditësi i është referuar provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, siç janë: Kopja e kontratës për bashkim të fondeve të datës .. nëntor.., kopja e vendimit, nr.1301 të datës 18IV

2002, Beograd për shpalljen e blerësit të lokalit, L2 me sipërfaqe 63.03 m² kopja e faturës, nr.01/02-OS e datës 19 qershor 2002 për kryerjen e pagesës sipas kontratës së shitblerjes Nr....e datës 18 IV02002, vërtetimi, Nr.... për ekzekutimin e pagesës nga paditësi e veçmas: kopja e kontratës së shitblerjes, Nr....e datës 18.IV.2002 e lidhur në mes, Shoqerisë Alcionare "Nacional" me seli në Beograd dhe I I nga Prishtina për blerjen e lokalit. Kolegji i shkallës së I-rë, ka konsideruar në mënyrë të qartë se paditësi, prapë se prapë nuk e ka bërë të besueshme ekzistimin e së drejtës tij subjektive që të pranohet propozimi i tij për caktimin e masës së sigurimit, pa paragjykuar në vendosjen e tij kësaj lidhur me pjesën kryesore të kërkesë padisë së paditësit-anulimi i vendimit, nr.ref.BD-189/29 të datës 30 tetor 2023 të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Bazuar në dokumentet e paraqitura, për natyrën e pretenduar juridikë si dhe duke qenë se lokali afarist nuk evidentohet as në emrin e të paditurës AKP-së, e njëjta nuk mund të zhvillojë procedurën e perënduar të tenderimit të asetit-lokalit afarist, L 2, me sipërfaqe prej 63.03m², me adresë në Prishtinë, Dardania, kati i ndërmjetëm dhe i cili është blerë nga paditësi që mese 20 vite si dhe deri më tani për tani nuk ka arsye që paditësit do t'i shkaktohej dëm i pariparueshëm nga veprimet e të paditurës.

Shkalla e I-rë e DHPGJS, ka konstatuar se parakushti mbi provat e besueshme sipas nenit 61 të ligjit të DHPGJS me rastin e paditësit, nuk është plotësuar derisa kjo gjykatë mori për bazë edhe pretendimet e të paditurës, të bëra në përgjigjen e saj të dhënë në propozimin e paditësit, AKP-ja si menaxhuese e asetëve të NSH-së, ka vepruar drejtë në pajtim me Ligjin për AKP-në kur e ka bërë aprovimin e raportit Shqyrtues të Komisionit për shqyrtimin e KPS-së të datës 15 shtator 2023, lidhur me statusin juridik të asetëve PS/SDR/-1537U/PRN193, Ndërmarrjes Organizatës së Punës, "Nacional" në Prishtinë, e duke i propozuar gjykatës, që të refuzohet propozimi për caktimin e masës së sigurimit. Shkalla e I-rë në arsyetimin e saj po ashtu ka konstatuar në rastin konkret nuk është plotësuar kushti i parë ligjor nga neni 61 par 1.1 i ligjit për DHPGJS, probabilitet se ekziston e drejta e kërkuar (fumus boni iuris), dhe se ekziston rreziku i shkaktimit të dëmit të menjëhershëm dhe të pa riparueshëm në rast se masa e sigurimit nuk ndërmerret, andaj edhe kjo gjykatë konsideron se propozimi i paditësit për caktimin e masës së sigurimit, nuk i plotëson kriteret ligjore në frymën e nenit 61 par.1 të Ligjit të Dhomës së Posaçme.

Me 14 shkurt 2022, paditësi nëpërmjet përfaqësuesit e dorëzon në DHPGJS një ankesë të afatshme kundër Aktvendimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS C-I-23-0048 të datës 23 janar 2024, për shkak të shkeljeve të dispozitave procedurale dhe për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plot të gjendjes faktike dhe kërkon nga Kolegji i Apelit që të aprovohet ankesa e tij si e bazuar, të ndryshohet Aktvendimi i ankimuar dhe të caktohet masa e sigurimit e propozuar në bazë të kërkesës së paditësit dhe të i ndalohet të paditurës, që ta shes, tjetërsoj në çfarëdo forme, ngarkoj, fsheh disponoj/administroj me Lokalin 2, sipërfaqe 63.03 m², me adresë Rr. D, kati i ndërmjetëm.

Paditësi/ankuesi në ankesën e parashtruar konsideron se Shkalla e I-rë i referohet nenit 76.3 të LDHPGJS, i cili përcakton zbatimin përshtatshmërisht të dispozitave të LPK-së lidhur me ndonjë çështje procedurale e cila nuk rregullohet mjaftueshëm me LDHPGJS. Shkalla e i-rë në kë rast ka marrë për bazë nenin 399 të LPK-së i cili rregullon procedurën kur pas pranimit të përgjigjes në padi, gjykata konstaton se nga faktet e treguara në padi del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë gjykata e refuzon si të pa themeltë kërkesëpadinë. Së pari neni 399 i referohet veprimeve procedurale për çështjen meritore, dhe nuk i referohet veprimeve procedurale të masës së sigurimit, së dyti përgjigja në padi dhe kundërpërgjigja në përgjigjen në padi rregullohen hollësisht me LDHPGJS, sipas dispozitave të nenit 37 dhe 38.

Ankuesi në ankesën e parashtruar pranë kolegjit të apelit konsideron se parakushti mbi provat e besueshme nga neni 61.1 të LDHPGJS, në rastin e paditësit nuk është plotësuar deri sa kjo gjykatë mori për bazë edhe pretendimet e të paditurës të bëra në përgjigjen e saj e saj të dhënë në propozimin e paditësit se ajo si menaxhuese e NSH-ve ka vepruar drejtë në pajtim me Ligjin për AKP-në kur e ka bërë aprovimin e raportit Shqyrtues të Komisionit për shqyrtimin e KPS-së të datës 15 shtator 2023, duhet të behet e qartë se marrja për bazë e konstatimeve të paditurës të masës së sigurimit lidhur me ligjshmërinë e raportit shqyrtues të AKP-së për shqyrtimin e AKP pers shqyrtimin e KPS-ve, nga i cili ka derivuar vendimi Nr.BD-189/29, anulimi i të cilës është objekt shqyrtimi në çështjen meritore sipas padisë së paditësit, nuk mund të jetë objekt shqyrtimi në procedurën gjyqësore për masë të sigurimit, në rastin konkret janë tejkaluar kushtet e përcaktuara me nenin 61 të LDHPGJS, respektivisht kemi shkelje të kësaj dispozite.

Paditësi në ankesën e parashtruar e kundërshton konstatimin e shkallës së I-rë ku thuhet se paditësi nuk e ka bërë të besueshme ekzistimin e të drejtës subjektive, por nuk ka dhënë arsye si janë vlerësuar këto provat, nuk është dhënë arsye përse paditësi nuk e ka bërë të besueshme ekzistimin e të drejtës subjektive si dhe nuk është bërë i ditur fakti se mbi bazën apo në mungesën e cilave prova paditësi nuk ka mundur ta vërtetoj ekzistimin e të drejtës së tij. Andaj paditësi në ankesë konsideron se Shkalla e I-re ka bërë shkele të nenit 160 të LPK-së në ndërlidhje me nenin 175 të LPK-së, të cilat zbatohen përshtatshëmrisht në këtë procedurë dhe pranë kësaj gjykate sipas nenit 76.3 të LDHPGJS. Paditësi po ashtu në ankesën e parashtruar konsideron se është non sens fakti se shkalla e I-rë nuk e ka konstatuar probabilitetin ekzistimin e të drejtës së paditësit mbi bazën të cilave ua ka falur besimin, rrjedhimisht do të ishte tejet me interes për paditësin ta dijë se përkundër proave; kontratës për bashkim të fondeve të datës .. nëntor .., shpalljes publike të datës 04 qershor 2022 në gazetën zyrtare "Privedni Preglad", vendimit për shpalljen e blerësit të lokalit L2 me sipërfaqe 63.03 m², faturës 01/OS për pagesën e çmimit të banesës, vërtetimin për ekzekutimin e pagesës nga paditësi të cilat kronologjikisht përcaktojnë rrjedhën e fitimit të pronësisë së paditësit, çfarë prove tjetër do të mund të parashtrohej nga propozuesi i masës së sigurimit për të vërtetuar ekzistimin e të drejtës subjektive. Paditësi gjithashtu e kundërshton konstatimin e shkallës së I-rë pasi që e cila ka konstatuar se e paditura nuk mund të ndërmarre veprime juridike që asetin i cili është objekt i shqyrtimit në këtë procedurë gjyqësore ta vendosë në procedurë të tenderimit publik për shitje, tjetërsim, ngarkim për shkak se e njëjta në regjistrat kadastral nuk evidentohet si pronare. Një konstatim i tillë është tejet i gabuar dhe është në kundërshtim me të gjitha faktet dhe provat të cilat janë parashtruar në këtë procedurë gjyqësore e sidomos me dispozitat e nenit 2 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit si dhe privat të cilat i ka parashtruar vetë kundërshtarja e masës së sigurimit. Paditësi konsideron se, kundërshtarja e masës së sigurimit në bazë të raportit shqyrtues të KPS-ve të cilën e ka bashkangjitur si provë e ka vërtetuar faktin se aseti në fjalë(Lokali L 2 ,63.03,m²) sipas saj dhe në Beograd kësisoj e njëjta është në administrimin de likuidimin e Ndërmarrjeve dhe "aseteve"(theks i shtuar), të

përkufizuar në këtë ligj, rrjedhimisht e njëjta mund të administrojë lirshëm me lokalin i cili është objekt kontesti sipas kësaj dispozite.

Paditësi ka konsideruar se Shkalla e I-rë është tejet kundërthënës në arsyetimin e saj, fillimisht e merre për bazë konstatimin e të paditurës, se e njëjta ka vendosur drejtë në bazë të raportit për shqyrtimin e KPS-ve, respektivisht aseteve të ndërmarrjes Organizata e punës "Nacional" që i bije praktikisht kjo e fundit e ka në administrim lokal in i cili është objekt kontesti, ndërsa në anën tjetër konstaton se paditura nuk mund ta tjetërsoj lokal in i cili është objekt i shqyrtimit meqenëse nuk është evidentuar si pronar i saj në regjistrin kadastral.

Paditësi ka theksuar se ky rast, nuk është rasti i parë i llojit të tillë për të cilën gjykata ka caktuar masën e sigurimit. Rasti i njëjtë analogjik për të cilin Kolegji i Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme ka vendosur në bazë të aktvendimit nr.AC-I.-22-0447, sipas të cilit ishte aprovuar ankesa e paditësit dhe ishte caktuar masa e sigurimit. Sipas këtij vendimi mund të kuptohet qartë se kundërshtarja e masës së sigurimit e kishte vënë në shitje lokal in përmes tenderit edhe pse në regjistrat publik nuk evidentohet si pronare e saj. Si provë e ka bashkangjitur kopjen e Aktvendimit AC-I.-22-0447, i datës 22 shtator 2022. Paditësi në ankesë konsideron se shkalla e I-re, në rastin konkret duke konstatuar faktin se e paditura nuk mund të tjetërsojë përmes tenderit publik lokal in i cili nuk evidentohet në emrin e saj, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të ligjit të AKP-së si dhe kundërshtim me vet praktikën gjyqësore të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme.

Shkalla e I-rë kishte marrë për bazë raportin shqyrtues të KPS-ve, të cilin e ka bashkangjitur si provë e paditura për refuzimin e kërkesës së paditësit për caktimin e masës së sigurimit. Paditësi në ankesën e parashtruar nëpërmjet përfaqësuesit konsideron se po të analizohej ky raport, mund të vihet në përfundim se nuk është gjetur asnjë provë mbi bazën e të cilës do të mund të vijë në përfundim se organizata "Nacional" ose ndonjë njësi e saj ka qenë apo është regjistruar në Republikën E Kosovës.

Në bazë të aktvendimit të atakuar, shkalla e I-rë ka konstatuar se paditësi nuk e ka bërë të besueshme ekzistimin e të drejtës së tij subjektive pavarësisht besueshmërisë së provave të parashtruara. Paditësi në ankesën e parashtruar pranë kolegjit të apelit konsideron se gjykata nuk i ka shqyrtuar drejtë dhe plotësisht provat për rrezikun e dëmit të menjëhershëm dhe të pa riparueshëm, duke krijuar një iluzion i cili bie në kundërshtim me praktikën e DHPGJSK-së si dhe të AKP-së, se në rastin konkret nuk ekziston rreziku i shitjes, transferimit dhe likuidimit të asetit i cili nuk është i regjistruar në emrin e AKP-së. Shkalla e I-rë mbi këtë bazë të gabuar ka konstatuar mosplotësimin e kushtit të dytë kumulativ të nenit 61 të LDHPGJS, ekzistimin e rrezikut të dëmit të menjëhershëm dhe të pa riparueshëm. Po ashtu Shkalla e I-rë nuk e ka shqyrtuar kërkesën e të paditurës me të cilën kishte kërkuar nga propozuesi që largohet nga prona e tij, apo të lidh marrëveshje kontraktuale me AKP dhe lokalit ta mbajë me qira, në rast së zgjidhet opsioni i dytë paraprakisht paditësi është detyruar të paguajë qiranë në mënyrë retroaktive për 3 vitet e fundit. Si kundërshtim i kësaj kërkesë, paditësi me të drejtë ka kërkuar mbrojtje ligjore pranë kësaj gjykate, sepse në rast të mos caktimit të masës së sigurimit shkaktimit të dëmit të menjëhershëm është i pa evitueshëm, e në të njëjtën kohë rreziku nga procesi i tenderimit publik për shitjen e lokalit objekt i këtij kontesti dëm i riparueshëm.

Dëmi i menjëhershëm konsiston në atë se paditësi përveç se do të detyrohet të largohet nga prona e tij kundërligjshëm, lokali afarist do të vendoset nën administrimin e AKP-së, ndërsa paditësi do të detyrohet të paguajë një qira me vlerë të caktuar nga e paditura në mënyrë të njëanshme dhe autoriteteve dhe atë për një periudhë retroaktive 3 vjeçare e që nga një kalkulim i përafërt që i bierë rreth 18.000 deri në 20.000 euro të cilat do të duhej të paguhen menjëherë në formë avanci, duke vijuar pastaj me pagesa të qirave mujore. Përveç kësaj AKP menjëherë në raundin e radhës do të vendoste asetin në shitje përmes tenderit publik. Shitja e asetit do të nënkuptonte dorëzim në posedim dhe pronësi të asetit tek një person i tretë, pavarësisht nga pretendimet pronësore të paditësit. Nëse ndodh shitja e asetit për të cilën paditësi ka iniciuar këtë padi, kjo cenon të drejtën në gjykim të drejtë (Neni 6 i KEDNJ) dhe të drejtën në mbrojtje të pronës (neni 1 protokollit i 1 i KEDNJ).

Paditësi konsideron se dëmi i pariparueshëm konsiston në atë se nuk ka një zhdëmtim të arsyeshëm financiar, sado që gjykata do të caktonte çmim për lokalin afarist kontestues i cili do të ia kompensonte të drejtën e mohuar në mënyre të kundërligjshme për gëzimin dhe shfrytëzimin e të drejtës pronësore për aset in e blerë tash e afër 20 viteve më parë.

Më 29 shkurt 2024, AKP-ja ka parashtruar përgjigjen në ankesë me të cilën ka propozuar që të refuzohet në tersi si e pa bazuar ankesa e paditësit/ankuesit dhe të vërtetohet Aktvendimi i kolegjit të Dhomës së Posaçme nr.C-I.-23-0048 të datës 23 janar 2024. AKP-ja ka theksuar se qëndron pranë të gjitha thënieve dhe provave të paraqitura nga ana e Kolegjit pranë Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, me të cilat ka refuzuar të gjitha pretendimet e paditësit/ankuesit të paraqitura në kërkesën për caktimin e masës së sigurisë. AKP-ja në përgjigjen në ankesë konsideron se ankuesi as me ankesën e paraqitur kundër Aktvendimit nr.C-I.-23-0048, të Dhomës së Posaçme, nuk ka arrite të paraqes ndonjë bazë juridike të besueshme, dheas nuk ka mundur ka mundur të konstatojë një gjendje tjetër faktike prej asaj siç ka vërtetuar Dhoma e Posaçme me Aktvendimin e atakuar C-I.-23-0048 të datës 23 janar 2024. AKP-ja konsideron se pretendimet e paraqitura në padi nuk janë të mbështetura me dëshmi dhe fakte materiale që do të ishin relevante për rastin konkret andaj mungesat e tilla, ankesën e bëjnë të paqëndrueshme.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e paditësit është e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktvendimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se Agjencia Kosovare e Privatizimit me Vendimin, NR.REF.BD-189/29 të datës 30 tetor 2023 e kishte aprovuar Raporti Shqyrtues i Komisionit për Shqyrtimin e KPS-së i datës 15 shtator 2023 lidhur me statusin juridik të aseteve, KPS/SDR-153U/PRN193, Ndërmarrjes Organizatë e Punës, "Nacional" Beograd, asetet në Prishtinë, Kosovë. Padiësi në padinë e 19 dhjetor 2023, të parashtruar pranë DHPGJS-së ka kërkuar nga gjykata që ta aprovojë në tersi kërkesëpadinë, dhe ta anulojë Vendimin, NR.REF.BD-189/29 të datës 30 tetor 2023 të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe të obligohet e paditura që ti paguajë shpenzimet gjyqësore lidhur me këtë çështje gjyqësore. Po ashtu ka propozuar që të caktohet Masa e Sigurimit të i ndalohe të paditurës që të ndërmarre veprime në drejtim të shitjes, tjetërsimit, fshehjes, ngarkimit apo disponimit/administrimit me lokalin afarist L2, me sipërfaqe prej 63.03 m², me adresë në Prishtinë, lagja D kati i ndërmjetëm, i cili është në posedim të padiësit, si dhe të obligohet e paditura që ta pezullojë zbatimin e vendimit nr.Ref.BD-189/29 të datës 30 dhjetor 2023 deri në zgjedhjen meritore të kësaj çështje.

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së, ka marrë Aktvendimin C-I-23-0048, me të cilin ka refuzuara si të pa bazuar kërkesen e padiësit-Propozuesit të sigurimit. Në arsyetim të vendimit thuhet se Gjykata pasi ka bërë shqyrtimin e propozimit për caktimin e masës së sigurimit si dhe pretendimet e të paditurës të dhëna në përgjigjen e saj dhe në kundërpërgjigjen e saj ndaj përgjigjes së padiësit, ka ardhë në përfundim se propozimi i padiësit për lëshimin e masës së sigurimit, në këtë çështje juridike është i pa bazuar. Shkalla e I-rë kishte konstatuar se nuk ishin plotësuar kushte për caktimin e masës së sigurimit të parapara në nenin 61 par.1 të Ligjit nr.06/L086 të DHPGJS.

Nenit 61 të Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji për

Dhomën e Posaçme), Dhoma e Posaçme mund të nxjerr një masë të sigurimit me kusht që parashtruesi të ofrojë prova të besueshme për ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij dhe se do të ketë dëme të menjëhershme dhe të pariparueshme për palën nëse nuk miratohet masa e sigurimit. Dëmi konsiderohet sii pariparueshëm vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar.

Paditësi i cili kërkon caktimin e masë së sigurimit duhet të dorëzoj dëshmi të besueshme se:

1. ekziston e drejta, dhe
2. kjo e drejtë mund të dëmtohet në mënyrë të pariparueshme nëse nuk miratohet masa e sigurimit.

Kolegji i apelit konstaton se barra e provës është tek paditësi, kështu që paditësi përveç që duhet të ofrojë dëshmi të besueshme se e drejta e tij ekziston, ai duhet të ofrojë dëshmi dhe ta bëj të besueshme faktin se do të shkaktohet dëm i menjëhershëm dhe i pariparueshëm, nëse nuk aprovohet kërkesa për masë të sigurimit.

Kolegji i Apelit ndryshe nga Kolegji i shkallës së parë vlerëson se paditësi me provat e dorëzuara, e të cilat gjenden në shkresat e lëndës, siç janë: Kopja e kontratës për bashkim të fondeve të datës .. nëntor ..., kopja e vendimit, nr... të datës 18IV 2002, Beograd për shpalljen e blerësit të lokalit, L2 me sipërfaqe 63.03 m2, kopja e faturës, nr.01/02-OS e datës 19 qershor 2002 për kryerjen e pagesës sipas kontratës së shitblerjes Nr....e datës 18 IV02002, vërtetimi, Nr... për ekzekutimin e pagesës nga paditësi, kopja e kontratës së shitblerjes, Nr....e datës ..,.... e lidhur në mes, Shoqërisë Alcionare "Nacional" me seli në Beograd dhe paditësit në këtë stad të procedurës e ka bërë të besueshëm faktin ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive, por kushti tjetër për dëm të menjëhershëm nuk është plotësuar.

Në këtë aspekt kolegji i Apelit vlerëson se nuk janë plotësuar kushtet e dispozitës së nenit 61 për caktimin e Masës së sigurimit, pasi që paditësi nuk e ka paraqitur ndonjë rrethanë, nga e cila pritët të pësojë ndonjë dëm të menjëhershëm dhe te

pariparueshëm, meqë sipas kërkesave ligjore përveç që duhet të bëhet e besueshme e drejta e pretenduar, duhet që paditësi të dorëzojë dëshmi të besueshme se kjo e drejtë mund të dëmtohet menjëherë dhe në mënyrë të pariparueshme, nëse nuk miratohet kërkesa për masë të sigurimit. Në rastin konkret paditësi nuk ka dorëzuar ndonjë provë se e paditura ka shpallur ndonjë tender për shitjen e lokali afarist me adresë në Prishtinë, rr."D",SU-1/1/3A,L2, me sipërfaqe të përgjithshme prej 63.03 m², gjë e cila do të paraqiste një dëm i menjëhershëm, pasi që e paditura do kishte mundësi ta shiste lokalin në fjalë. As e paditura në përgjigjen e ndaj kërkesë për caktimin e masë së sigurimit nuk ka shprehur ndonjë gatishmëri për shitjen e lokalit në fjalë. Edhe Vendimi i Bordit të Drejtorëve të AKP-së, Nr.ref.BD-189/29 të datës 30 tetor 2023 me të cilin është aprovuar Raporti Shqyrtues i Komisionit për Shqyrtimin e KPS-së i datës 15 shtator 2023 lidhur me statusin juridik të aseteve, PS/SDR/-153U/PRN193, Ndërmarrjes Organizatë e Punës, "Nacional" Beograd, asetet në Prishtinë, nuk është vendim me të cilën Bordi e AKP-së ka vendosur ta tenderoj apo ta shes objektin kontestues, andaj edhe në këta aspekt nuk ekziston rreziku i shitjes ashtu siç perëndon paditësi. Vendimi i kontestuar i Bordit të AKP-ë vetëm merret me administrimin e NSH-së dhe asetet e saj, përfshirë edhe lokalin i cili është objekt i kësaj çështje, që do të thotë marrja nën administrim nga AKP nuk nënkupton se lokali ka dal në shitje.

Po ashtu është i pabazuara edhe pretendimi i paditësit se rasti i tij është rast i njëjtë me një Aktvendim të Kolegjit të Apelit të DHPGJS nr. AC-I.-22-0447, ku Kolegji i Apelit kishte caktuar mesën e sigurimit dhe se duhet të përdoret analogjia. Kolegji i Apelit vëren se tek rasti AC-I.-22-0447, që i referohet paditësi e paditura e kishte shpallur tenderin e shitjes për asetin që ishte objekt i kontestit, dhe se rreziku i shitjes së pronës ishte evident, ndërsa tek rasti i paditësit siç arsyetuar më lart e paditura nuk ka tenderuar për shitje lokalin që është objekt i kontestit.

Prandaj në këtë fazë të procedurës pavarësisht se paditësi ka sjellë prova për ekzistimin e kërkesës së tij, prapë nuk mund të caktohet masa e sigurimit pa u plotësuar edhe kushti tjetër meqë siç theksuam me larët parashtuesi nuk ka ofruara prova të besueshme se do të ketë dëme të menjëhershme dhe të pariparueshme për palën nëse nuk miratohet masa e sigurimit.

Në rastin konkret, Kolegji i Apelit vlerëson se pa paragjykuar rrezikun në të ardhmen dhe themelësinë e kërkesës kryesore, një rrezik i tillë nuk ekziston, pasi që lokali afarist kontestues nuk ka dalë në shitje dhe AKP nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të tjetërsimit apo ngarkimit të tij nga e paditura.

Përderisa paditësi nuk kanë ofruar dëshmi të besueshme se ekziston rreziku për dëm të menjëhershëm, kërkesa e paditësit për Masë caktimin e masë së sigurimit nuk ka mbështetje në dispozitën e nenit 61 të Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme.

Andaj për këto arsye, Kolegji i Apelit e refuzon ankesën e paditësit/ankuesit si të pa bazuar dhe e vërteton Aktvendimin e ankimuar si të drejtë dhe të bazuar në Ligj.

Ky aktvendim nuk prejjudikon zgjidhjen përfundimtare në meritat e padisë.

Prandaj nga këto arsye, e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Taksat gjyqësore

Pasi që Taksat gjyqësore është paguar nga ankuesi konform nenit 13.3 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore të nxjerrë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, ankuesi nuk ngarkohet me takes shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 14 mars 2024.

Mr.Sc Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues
